

VENDIMI
Nr.11, datë 27.8.1993

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Feti Gjilani,	Zv/Kryetar i	“	“
Manol Konomi,	Anëtar i	“	“
Hilmi Dakli,	Anëtar i	“	“
Franc Jakova,	Anëtar i	“	“
Thimjo Kondi,	Anëtar i	“	“
Natasha Sheshi,	Anëtare e	“	“
Ylvi Myrtja,	Anëtar i	“	“

me sekretare Drita Filto, më datat 9.7, 18.8 dhe 27.8.1993, shqyrtoi në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen që i përket:

KËRKUES: 265 qytetarë të Tiranës, të përfaqësuar nga zoytërinjtë Leonidha ashi, Vasil Dede, Pirro Polo, Bektash Kasmi, si dhe nga avokati Krenar Loloçi.

OBJEKTI:

Pakushtetutshmëria e Ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe Ligjit Nr.7698, datë 15.04.1993 "Për rikthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", në pjesën që ato diskriminojnë qiramarrësit e banesave që iu kthyen ish-pronarëve në krahasim me qiramarrësit e banesave shtetërore që privatizohen.

GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi dëgjoi relacionin përkatës, dëgjoi përfaqësuesit e kërkuësve z.Leonidha Dashi, Vasil Dede, Pirro Polo dhe Bektash Kasmi të cilët kërkuan të vendosin sipas kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN

Kërkuësit prej vitesh janë qiramarrës në banesat që në mënyrë arbitrare iu kanë qenë shtetëzuar, shpronësuar, konfiskuar etj, pronarëve të tyre të ligjshëm dhe që tani iu janë kthyer atyre me Ligjin Nr.7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve".

Ata parashtrojnë se me ligjin e sipërcituar dhe me Ligjin Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", vihen në pozitë të diskriminuar në krahasim me qiramarrësit e banesave shtetërore, çka vjen në kundërshtim me parimin kushtetues të barazisë së qytetarëve para ligjit, për këto arsye:

1. Paragrafi i parë i nenit 14 të Ligjit Nr.7698, datë 15.04.1993, nuk qëndron, pasi Ligji Nr.7652, datë 23.12.1992 nuk na quan të pastrehë.

Qeveria, sipas nenit 16 të Ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992, me Vendimin Nr.49, datë 29.01.1993, na quan padrejtësisht të pastrehë. Ky cilësim vjen në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit Nr.7692, datë 31.03.1993 "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

E drejta e jonë e qiramarrësit nuk mund të na kufizohet duke i dhënë të drejtë pronarit të ri të na nxjerrë nga banesa.

2. Qiramarrësit e banesave shtetërore i marrin ato falas, ose duke paguar gjithsej 30.000 lekë, kurse ne do t'i kthejmë shtetit kredinë prej rreth 1.500.000 lekë.

3. Qeveria për ne duhet t'i caktojë qiratë në raport me nivelin tonë ekonomik. Po të lihet siç është në ligjin e ri, kjo ndryshon kushtet e kontratës që kemi me shtetin e na ve në kushte të disfavorshme nga pozita që kemi sot. Prandaj shteti duhet të na sigurojë banesë dhe

ta paguajmë sikurse e paguajnë qiramarrësit që banojnë në shtëpitë e ndërtuara nga shteti.

Gjykata vëren, se Ligji Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe Ligji Nr.7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", rregullojnë problemet e privatizimit të banesave shtetërore dhe kthimit e kompensimit të pronave ish-pronarëve.

Sipas këtyre ligjeve ndër të tjera, qiramarrësve të banesave të ndërtuara nga shteti iu është dhënë e drejta t'i privatizojnë ato në kushtet e caktuara në ligj, ndërsa qiramarrësve të banesave që iu kthyhen ish-pronarëve ju është njohur e drejta që për zgjidhjen e problemit të strehimit të tyre të marrin kredi nga institucionet e caktuara për këtë qëllim dhe pjesa e interesit të kredisë për ndërtimin ose blerjen e këtyre ndërtesave do të përballohet nga buxheti i shtetit, siç përcaktohet shprehimisht në nenin 16 të Ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", ose të sistemohen si qiramarrës në banesat që do të ndërtojnë shteti - neni 25 i po atij ligji.

Zgjidhja e ndryshme e problemeve të strehimit që kanë këto kategori qiramarrësish nuk vjen për shkak të ndonjë diskriminimi që bëhet ndërmjet tyre, por për shkak të pozitave të ndryshme që kanë ata në fakt, të parët si qiramarrës të banesave të ndërtuara nga shteti, të dytët si qiramarrës të banesave që ju kthehen ish-pronarëve.

Pretendimi i kërkuesve dhe avokatit të tyre në gjyq se me Ligjet Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore" dhe Nr.7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", kërkuesit diskriminohen në krahasim me kategoritë e tjera të qiramarrësve, duke u cënuar kështu neni 25 i Ligjit Nr.7692, datë 31.03.1993 "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut", nuk është i bazuar.

Sipas kësaj dispozite (neni 25) "të gjithë janë të barabartë në ligj dhe para ligjit.

Askush nuk mund të diskriminohet për shkak të seksit, racës, etnisë, gjuhës, fesë, gjendjes ekonomike dhe financiare, arsimore dhe sociale, bindjes politike, përkatësisë prindërore apo për çdo lloj rrethane tjetër personale".

Siç u trajtua më sipër, në ligjet objekt gjykimi, nuk është bërë asnjë dallim për shkaqet e parashikuara në nenin 25 të Ligjit "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivist të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta.

I pabazuar është pretendimi i kërkuesave se duke u quajtur ata të pastrehë sipas nenit 16 të Ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.49, datë 29.01.1993, cënohet neni 41 i Ligjit Nr.7692, datë 31.03.1993 "Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut". Neni 41 i këtij ligji bën fjalë për kufizimin e përkohshëm të disa të drejtave të sanksionuara po në atë ligj dhe që nuk kanë të bëjnë fare me objektin e kërkesës. Në të kundërt nga sa pretendohet, duke u quajtur të pastrehë, ata jo vetëm nuk cënohen, por favorizohen, sepse ju jepet e drejta të marrin kredi pa interes për ndërtim banese.

Sa ka parashtruar avokati i kërkuesve në materialin, që i ka dorëzuar Gjykatës për detyrimin e kërkuesve të dalin nga banesat ku janë qiramarrës pas 3 vjetësh në bazë të nenit 7 të Ligjit Nr.7698, datë 15.04.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", nuk qëndron. Kjo dispozitë bën fjalë për banesat private që përdoren nga shteti për qëllime publike dhe jo për banesat që kanë me qira kërkuesit.

Marrëdhëniet ndërmjet kërkuesve si qiramarrës dhe pronarëve që ju kthehen si qiradhënës edhe në të ardhmen do të rregullohen në bazë të dispozitave ligjore në fuqi, sikurse për çdo qiramarrës tjetër.

Sipas nenit 19 të Ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", për banesat pronë private dhe banesat shtetërore ish-pronë private nuk lejohet liberalizimi i qirasë para muajit dhjetor 1995.

Sipas nenit 25 të po këtij ligji, shteti në të ardhmen do të marrë pjesë në zgjidhjen e problemit të strehimit të banorëve të qyteteve nëpërmjet institucioneve të specializuara për këtë qëllim dhe se banesa me qira do të përfitojnë edhe qiramarrësit e banesave private, të cilët lirojnë banesën si rezultat i kthimit të saj pronarit.

Nga dispozitat që u përmendën më sipër, rezulton se kërkuesve, për zgjidhjen e problemit të strehimit, ju është dhënë alternativa të ndërtojnë banesa me kredi, interesin e së

cilës e mbulon shteti, ose të sistemohen si qiramarrës në banesa që do të ndërtojë shteti.

Nga gjithë sa u parashtrua më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuessve, për çështjen që kanë paraqitur, nuk ju është cënuar asnjë e drejtë kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 24, 25, 26 dhe 27 të ligjit nr.7561, datë 29.4.1992, “Për disa ndryshime dhe plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.12991, “Për dispozitat kryesore kushtetuese”,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.